

**PERMBLEDHJA NE GJUHEN JO TEKNIKE
PER**

**AKTIVITETIN
BLUARJE DHE FRAKSIONIM I GURIT**



Studio “**COMERCIR**” sh.p.k

Msc. Ing. Apostol QIRKO

Msc. Ing. Athinta QIRKO

MAJ 2014

QELLIMI

Shoqeria "Bakia Beton" sh.p.k ka per qellim bluarjen dhe fraksionimin e gurit duke prodhuar inerte me granulometri te ndryshme. Kjo kerkon ti ofroj tregut Shqiptar, produkte cilesore dhe me cmime te arsyeshem. Projekti i paraqitur nga shoqeria ka per qellim te ofroje sherbime te klientela, si dhe te pasqyroje ndikimet e mundshme ne shendet dhe mjesdis gjate ketij aktiviteti. Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

Per te realizuar respektimin e mjesdit dhe per te ulur ndikimin e impaktit ne mjesdi, shoqeria e cila ndodhet nen administrimin e z. Clirim Bakia, ka bere nje pune te kujdeshme kerkimore, ne menyre qe te mos shkaktoje probleme tek banoret dhe mjesdi perreth. Gjithashtu jane siguruar metoda, mjete dhe makineri bashkekohore per zhvillimin e aktivitetit.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

Shoqeria:	"Bakia Beton" sh.p.k
NIPT:	048148010L
Administrator:	Clirim Bakia
Objekti:	Prodhim inertesh me granulometri te ndryshme
Vendndodhja:	Shoqeria "Bakia Beton" sh.p.k ndodhet ne fshatin Borsh, Sarande.
Siperfaqja e sheshit	10 400 m ²
Siperfaqja e ndertimit	15000 m ²

PROCESI I PUNES

Perpunimi i gurit ne kete impiant konsiston ne proceset teknologjike te cilat jane vazhdimesi e njeri – tjetrit dhe ne momente te caktuara nderthuren bluarja - thyerja dhe fraksionimin. Makinerit dhe pajisjet teknologjike jane te thjeshta ne perdorim dhe te sigurta, por sidoqofte, per te patur nje pune me vijmesi normale dhe pa rreziqe, ato kane nevoj per mirembajtje dhe riparime te kualifikuara, qe duhet te kryhen nga persona me perqatitje profesionale. Keto makineri vihen ne levizje nga energjia elektrike me fuqi te instaluar 300kw. Si lende te pare perdoret guri i cili meret nga kontrata e bere nga shoqeria me administratorin e karieres se shfrytezimit te ketij guri.

Ky aktivitet ka ne kapacitet perpunues rreth 60m³/ore dhe nje fuqi puntore prej 8 persona.

Linja e bluarjes dhe fraksionimit te guritperbehet nga :

1. Bunkeri (Ushqyesi)
2. Shosha
3. Fronjoja
4. Mulliri
5. Larese

6. Shosha
7. Tranportier
8. Kull komandimi impjantesh inertesh
9. Depozit uji
10. Vend depozitimi i materialit te pa perpunuar

Procesi eshte ne seri dhe furnizimi behet sipas planit te prodhimit dhe kerkesave te materialeve inerte, ne lloj dhe ne sasi.

Frantoja dhe shoshat vibruese dhe seleksionuese prodrojne kryesisht materiale inerte si rere e thyer, granil 1, granil 2, dhe rere e lare natyrale, sipas dimensioneve te shoshave ndarese ne nyje



Ne **linjen e thyerjes dhe fraksionimit te gurit** prodhohen kater lloj materialesh inerte si me posht.

- Rere e thyer
- rere e lare natyrale
- granil “1” me dimensione fraksioni 5-10mm
- granil “2” me dimensione fraksioni 10-25 mm..

Guri gelqeror transportohet nga shoqeria “Bakia Beton” sh.p.k per ne impiant me mjete transporti kamiona te medhenj qe jane ne pronesi te shoqerise. Keto kamione gurin e pa bluar e shkarkojne ne bunkerin e impiantit dhe prej andej kalon ne shoshe.



Prej ketu materiali materiali coptohet ne impiantin e thyerjes (Frantoja) dhe nepermjet transportierit kryesor kalon ne mullirin e bluarjes per te kaluar nje pjese ne transportierin i cili shkarkohet ne vendepozitimini e materialit granil 2, nje pjese me anet te transportierit kalon ne shoshen nr.6 dhe pjesa tjeter kalon ne lares, ku prej andej me ane te transportierit perkates, shkarkohet ne vendin e depozitimit te reres se lare natyrale.

Nga shosha nr.6 me ane te tranportiereve perkates nje pjese shkarkohet ne vendin e depozitimit te granilint 1 dhe nje pjese ne vendin e depozitimit te reres se thyer.

Teknologja qe perdor kjo shoqeri eshte teknologji e njom e cila bene te mundur parandalimin e emetimit te pluhurave gjate proceseve te punes.

Lendet ndihmese:

- **Energjia elektrike** me fuqi 300 kw meret nga rrjeti elektrik i fshatit sipas kontrates te lidhur nga pronari i shoqerise me KESH-in.
- **Uji** meret me ane te nje tubacioni nga lumi dhe shkarkohet ne depozitat qe zotron shoqeria.

MBETJET DHE EMETIMET NE MJEDIS

Me poshte jepet nje pershkrim i detajuar i mbetjeve dhe shkarkimeve te tyre ne mjedis, dhe drejtimet ne te cilat ato shkarkohen se bashku me efektet e mundshme te demshme qe mund te krijohen per tani dhe per nje te ardhme te larget.

Mbetje te ngurta

Procesi i bluarjes dhe fraksionimit eshte nje proces i cili shoqerohet me mbetjet teknologjike ne sasira te pa perfillshme. Keshtu, ne 1 m^3 gure gelqeror 1 – 2 % te tij perben material steril. I gjithe materiali steril depzitohet ne zonat afer impjantit te cilat jane te demtuara. Procesi i perpunimit te gurit ne impiant nuk shoqerohen me emetimet e demshme per mjedisin.

I vetmi element qe perdoret ne procesi teknologjik eshte guri gelqeror qe meret nga kariera e shfrytezimit te gurit ne afersi te impianitit te thyerjes. Procesi teknologjik i njom parandalon emetimin e pluhurave ne mjedis.

Mbetje te gazta

Si emetimi i vetem dhe kryesor eshte emetimi i gazrave qe dalin nga puna e fadromes dhe makinerive te transportit. Keto mjete jane te kolauduara dhe per pasoj elementet e tyre jane brenda normave te lejuara. Nisur nga energjia qe perdoret (elektrike) per venien ne pune te mekanizmit e paisjeve te impiantit, veme re se qe kjo energji eshte e paster dhe per pasoj nuk emeton element ndotes te mjedisit.


Zhurmat

Persa i takon emetimit te zhurmave, ato krijohen nga makinerit qe bejne te mundur fraksionimin dhe bluarjen e gurit gelqeror si dhe nga automjetet qe vijne dhe qe largohen nga objekti, por ato jane brenda normave te lejuara dhe nuk perbejne shqetesim per banoret, pasi impianti eshte ndertuar larg qendrave te banuara.

Studio "COMERCIR" sh.p.k

Msc. Ing. Apostol QIRKO

Msc. Ing. Athinta QIRKO



Borsh 14/05/2014